

Patriku Bullgar Neofit bekoi fëmijët dhe familjet e tyre



Në një liturgji Shenjtëria e Tij Patriku Neofit theksoi se fëmijët janë më e çmueshmja dhe më e shtrenjta për çdo njeri, për çdo familje, për çdo popull. Patriku tha se fëmijët janë bekim si për prindërit e tyre, ashtu edhe për mbarë shoqërinë. “Te ta është shpresa jonë për ditën e nesërmen” tha Patriku dhe u bëri thirrje të moshuarve të mos harrojnë fjalët e Krishtit, i cili na mëson të ruajmë pastërtinë e mendimeve dhe synimeve fëmijërore.

